



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Gramsh më ____/____/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburanti për nevojat e administratës së Bashkisë, drejtorive dhe sektorëve vartës

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Karburante 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: me fond limit **18 165 584** (tetëmbëdhjete milion e njëqind e gjashtëdhjete e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Vlera e fondit limit në monedhen ndërkombetare euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë është 190 155,804 euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankes së Shqipërisë për monedhen euro në datë 04.05.2026 është 95.53

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor bashkia Gramsh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, dhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, Shtojca 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2023,2024 dhe 2025 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2/b citohet: vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e ketij kriteri kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Gjithashtu vendosja e kriterëve ne reference eshte bere që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar, ne nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024,2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP(i ndryshuar), si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 10091 date 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. AK mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve, është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 5, datë: 30. 01. 2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit nr. 29, të ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **e maturuar (duke përfshirë këtu edhe këstet e maturuara për vitin 2026)** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

- 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me Licencë të tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) ose Autorizim për ushtrim aktiviteti “Tregti me pakice të lendeve djegëse Karburante”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1/a/c/ të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 40, pika 5, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, i cili përcakton se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë*

licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu, kjo kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” si dhe në VKM nr.970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.2. Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet kundrejt autoritetit kontraktor, operatori ekonomik duhet të paraqes listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacion të tregëtimin me pakicë të karburanteve 1 (një) pikë furnizimi/ stacion shitje me vendodhje në **Njësinë Administrative Gramsh/ Bashkia Gramsh**, të disponojë 1 (një) pikë furnizimi/ stacion shitje me vendodhje në **Njësinë Administrative Tirane/Bashkia Tirane**, të disponojë 1 (një) pikë furnizimi/ stacion shitje me vendodhje në **Njësinë Administrative Elbasan/Bashkia Elbasan**, , vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së, etj). Ky stacion furnizimi të jetë i pajisur me leje mjedisore, Vërtetim Teknik nga ISHTI ose nga një shoqëri e akredituar, Akt-Teknik nga PMNZH, dhe Policë Sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për shitjen me pakicë. *Për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqitet i gjithë dokumentacioni i cituar.*

1. **Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kriteri i vendosur për disponimin e 1 (një) pikë furnizimit/ stacion shitje është i domosdoeshëm për furnizimin e automjeteve të autoritetit kontraktor me mallin objekt prokurimi, ku duhet të paraqesë dokumentacionin ligjor të kërkuar për vërtetimin e disponimit të tij dhe ushtrimin e veprimtarisë në të sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, referuar nenit 15 të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”(i ndryshuar), Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (i ndryshuar),ligjit Nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar me ligjin nr.52/2020), Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.491, datë 19.07.2017 “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregëtimin e naftës,të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, dhe Urdhërit nr.315, date 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj”.Ky kriter është vendosur për arsye se marrëdhëniet e punës të bashkisë Gramsh janë të ndërlydhura me

institucione në këto njësi administrative për shkak të procesve gjyqësore që ndjekim, trajnimeve, konferencave etj. Dhe për efikasitet kohe kërkohet të ketë pika furnizimi në këto rrethe.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2025

Argumentimi: Me qëllim vërtetimin e besueshmërisë të operatorit ekonomik pjesëmarrës se ai ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqipëtar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje cilësie, në mbështetje të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 *“Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”* dhe akteve nënligjore, VKM Nr.147, datë 21.03.2007 *“Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”*, Urdhërit të Ministrit Nr.06, datë 09.01.2015 *“Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse”*, Njësia e prokurimit vlerëson se operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e kërkuar, lëshuar nga ISHTI.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rastin kur nuk është shoqëri tregtuese me shumicë, duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar të furnizimit me një shoqëri e cila është e licencuar për tregtimin me shumicë të produktit që prokurohet.

Argumentimi: Në zbatim të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 *“Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”* neni 15 pika 2 të tij, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë në rastin kur nuk është shoqëri tregtuese me shumicë, duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar të furnizimit me një shoqëri e cila është e licencuar për tregtimin me shumicë të produktit që prokurohet.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë-analizën e kontrollit të kryer në stacionin e tij, dhe/ose të furnizuesit të produktit, për produktin Diesel S SH EN 590:2022 dhe S SH EN 228:2012 + A 1 :2017 ose ekuivalente me to, të njohur nga Standartet Shqipëtare, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj duhet e përkthyer dhe e noterizuar në shqip), që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregton, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike e lëshuar jo më parë se muaji Dhjetor 2025.

Argumentimi:

Gjithashtu, në zbatim të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 *“Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”* neni 23 i tij, VKM-së Nr.147, datë 21.03.2007 *“Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”*, si dhe Urdhërit të Ministrit Nr.06, datë 09.01.2015 *“Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse”*, me qëllim verifikimin se produktet që operatori ekonomik

oferton **Diesel** janë sipas standarteve **SH EN 590:2022 dhe S SH EN 228:2012 + A 1 :2017 ose ekuivalente me to, të njohur nga Standartet Shqipëtare** të kërkuar në dokumentat standarte të proçedurës së prokurimit, Njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin fletë-analizën e kontrollit të kryer në stacionin e tij dhe/ose të furnizuesit për produktin objekt prokurimi, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike e lëshuar jo më parë se muaji Dhjetor 2025.

Kapacitetet dhe dokumentacioni ligjor i kërkuar, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur duhet të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me karte elektronike të personalizuar me targonë e cdo automjeti të autoritetit kontraktor sipas kërkesave të AK-se.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Karta elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 "Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targonë e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Disponimi/Ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin e shërbimeve të kërkuara më sipër, do të demonstrohen nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktike, në prani të anëtarëve të KVO-se së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.

Mosofrimi i Ndërfaqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), përbën kusht për skualifikim.

Argumentim: Në bazë të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar permbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të percaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 40, pika 8, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë asetet elektronike të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK.

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s’kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur me me Urdhërin e Zyrtarit të Autorizuar N/Kryetarit të Bashkisë Nr.20, datë 14.01.2026 “Ngritjen e Komisionit për përcaktimin e sasive, hartimin e specifikimeve teknike, testimin e tregut, hartimin e preventivit dhe përcaktimin e fondit limit për efekt të prokurimit të kontratës së blerjes së karburantit për nevojat e administratës së bashkisë, drejtorive dhe sektorët vartës.”

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.

- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

Loina Zogu

Luan Kokla

Erlinda Carciu

ZYRTARI I AUTORIZUAR
ZV/KRYETARI I BASHKISË

XHILSON BAJRAMI